



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2023:301053  
Datë: 10.03.2025  
Numri i dokumentit: 06958935

C.nr. 4841/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit Vegim Maloku, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit N H. nga Peja, kundër të paditurit Z. D. nga fshati N Komuna e Pejës, me bazë juridike: Kompensim dëmi, vlera e kontestit e pa përcaktuar pas shqyrtimit paraprak të padisë më datë 10.03.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET SE ËSHTË TERHEQUR padia e paditësit N H. nga Peja, kundër të paditurit Z. D. nga fshati N Komuna e Pejës, me bazë juridike: Kompensim dëmi, vlera e kontestit e pa përcaktuar.

A r s y e t i m

Paditësi nëpërmes ka paraqitur padi në këtë gjykatë, me dt.28.12.2023 kundër të paditurit, për kompensim dëmi.

Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, në ekzaminim paraprak të padisë, ka gjetur se padia e paditësit nuk e përmban vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar, andaj për këtë arsyeje gjykata me anë të vërejtjes gjyqësore të dt.04.10.2024, të cilën paditësi e ka pranuar me dt.06.02.2025, e ka ftuar që të paguajë taksën gjyqësore në shumë prej 20€, e paraparë me Udhëzimit Administrativ NR.02/2017 për ndryshimin e udhëzimit administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, dhe paditëses i ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi, sipas nenit 5,5.2,5.3 dhe 5.5,5.5.2 i këtij Udhëzimi Administrativ, dhe në bazë të dispozitës së nenit 253 pika 4 e 5 të LPK-së.

Sipas dispozitë se nenit 253.1, të LPK-së shprehimisht parashihet se çka duhet të përmbajë padia, sipas dispozitës se nenit 253.4, të këtij ligji, shprehimisht parashihet se paditësi ka për detyrë që padis ti bashkëngjit vërtetimin mbi taksën gjyqësor të paguar ndërsa sipas dispozitës së nenit 253.5 të këtij ligji, shprehimisht parashihet se në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padi e as pas vërejtjes se dërguar nga gjykata edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore do të konsiderohet se padia është e tërhequr.

Meqenëse pala paditëse përkatësisht, nuk ka vepruar në kuptim të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore për padi dhe gjykatës nuk i ka dorëzuar kërkesë - prova që ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksisë gjyqësore për padi e duke u mbështetur në depozitat e nenit 253.1,4 dhe 5, dhe nenin 387.1, pika ë), të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2023:301053, C.nr.4841/23, **10.03.2025**

Gj y q t a r i  
Vegim Maloku

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës se Apelit, nëpërmjet kësaj gjykatë.